



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1121 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 124, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër *projektit "TAP", për Tokat Shtesë për Depozitimin e Përkohshëm të Shtresës së Sipërme të Tokës (Topsoil) në Fier dhe Berat.-Subjekti "TAP AG"*, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "TAP", për Tokat Shtesë për Depozitimin e Përkohshëm të Shtresës së Sipërme të Tokës (Topsoil) në Fier dhe Berat.-Subjekti "TAP AG"*, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Subjekti "TAP AG", duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit të projektit "TAP", për Tokat Shtesë për Depozitimin e Përkohshëm të Shtresës së Sipërme të Tokës (Topsoil) në Fier dhe Berat, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al